VENDIM
Nr. 175, datë 7.11.2016

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "M.C INERTE LUMZI" SHPK, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "TUC" DHE "LUMZI"

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe në zbatim të neneve 4, pika 1, germa "a"; 5, pika 1, germa "a"; 10, pikat 1 dhe 3, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; gjithashtu, dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "M.C Inerte Lumzi" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et "Tuc" dhe "Lumzi", të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorit të Tregut,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "M.C Inerte Lumzi" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "e", "f", "g") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.2, 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d", 4.1.4, germat "b", "c", "d", "e") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë, me:

- Vërtetimin nga Gjykata dhe Prokuroria (neni 9, pika 2, germa "d");
- Të dhënat teknike për HEC-et (neni 9, pika 4.1.1);
- Studimi i fizibilitetit (neni 9, pika 4.1.4, germa "a");
- Pika e lidhjes dhe lejet nga institucionet e tjera (neni 9 pika 4.1.5 germat "a", "b", "c") do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", t`i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "M.C Inerte Lumzi" sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Tuc", me fuqi të instaluar 4470 MW; Hec "Lumzi", me fuqi të instaluar 11000 MW dhe fuqi totale 15470 MW.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti